



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:143138
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05749121

K.DH.SH.II.nr.1504/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ambienti” Sh.A., me numër unik identifikues 810538027 dhe seli në Pejë, rr. “Xhemë Sadrija”, kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1633/22 të datës 20.09.2023, me datën 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1633/22 të datës 20.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1633/22 të datës 20.09.2023, e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të

Brendshme, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.213/22 të datës 21.04.2022, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Zija Bala me seli në Pejë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkallës së parë ta ndryshoj, debitorit në bazë të nenit 129 të Ligjit për Gjykatën Komerciale ti bëhet kthimi në gjendje të mëparshme duke vendosur sipas prapësimit duke e rivendosur edhe afatin e prapësimit si të afatshme.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 23.10.2020, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm: Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste të kreditorit me numër 26963, ka lejuar Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 826/2020, të datës 23.10.2020, me të cilin është obliguar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej EUR 14,409.00, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e kalimi të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Përmbarruesi Privat Zija Bala me seli në Pejë duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lejuar urdhrin përmbarrimor P.nr.826/20 të datës 23.10.2020.

Kundër urdhrit përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 05.04.2022, përmes postës rekomande me numër R 2301974, ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor në tërësi me arsyetim se borxhi i akumuluar nuk është i debitorit mirëpo i njejt i

takon Kuvendit Komunal të Pejës, dhe se debitori nuk ka pasur asnjë marrëveshje me kreditorin ashtu që borxhi i është faturuar debitorit në mënyrë të jashtëligjshme. Po ashtu, ka theksuar se përmbaruesi privat ka qenë i obliguar që të kërkoj dëshmi nga kreditori në mënyrë që t'i identifikoj palët përmbarimore e pastaj të ndërmer veprime. Ndërsa, ka shtuar se borxhi i kërkuar nga kreditori është përfshi në parashkrim në kuptim të nenit 360 të LMD-së. Në fund, ka theksuar se përmbaruesi privat është dashur që shkresat t'ia dorëzoj avokaturës shtetërore ngase sipas Ligjit nr. 04/L-157 për avokaturën shtetërore përcaktohet se ky institucion jep këshilla dhe mbron autoritet publike në procedurë gjyqësore, të arbitrazhit dhe në procedurë administrative. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet. Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm ngase ka kaluar afati ligjor brenda të cilit debitori ka mundur të paraqes prapësim. Ndër të tjera ka theksuar se janë të pabazuara pretendimet e debitorit se nuk ka ndonjë marrëveshje me kreditorin për shërbime të mbeturinave, ngase për shërbime të tilla të veçanta nuk është e nevojshme lidhja e marrëveshjes. Në fund, ka theksuar se faturimi për shërbimeve të mbeturinave i është bërë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe jo Komunës së Pejës, ndërsa gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendim e ankimuar me arsyetim se sipas vlerësimit të Gjykatës së shkallës së parë, urdhrin Përmbarimor P.nr. 826/20 të datës 23.10.2020, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Zija Bala nga shkresat e lëndës rezulton se përmbaruesi privat Zija Bala ka tentuar që t'ia dorëzoj debitorit urdhrin përmbarimor, mirëpo që debitori me datë 05.11.2020 ka refuzuar ta pranoj urdhrin përmbarimor, fakt ky që vërtetohet nga konstatimi i zyrtarit të postës në flete kthesën për dorëzim personal e cila gjendet në shkresa të lëndës. Andaj, meqenëse debitori me datë 05.11.2020 ka refuzuar pa ndonjë arsye pranimitin e urdhrin përmbarimor, atëherë datë e pranimit të urdhrin duhet të merret data 05.11.2020, përkatësisht data e refuzimit të pranimit të dërgesës, kjo në mbështetje të nenit 112 i Ligjit për procedurën kontesimore (LPK), sipas së cilës dispozitë përcaktohet se: *“Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuari në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t'ia lejë në banesë ose në lokalet*

në të cilat punon personi i tillë apo do t'ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm". Në këtë drejtim, duke ju referuar dispozitës si më lartë, rezulton se urdhri përmbartimor debitorit i është dorëzuar me datë 05.11.2020, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 05.04.2022, përmes postës rekomande me numër R 2301974, e cili gjendet në shkresat e lëndës.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se "Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues", ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se "*Në qoftë se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.*"

Andaj, gjykata e shkallës së parë duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr. 826/20 të datës 23.10.2020, e ka pranuar me datën 05.11.2020, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimin ka filluar të rrjedhë nga data 06.11.2020, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimin ka qenë data 12.11.2020. Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 05.04.2022, përmes postës rekomande me numër R 2301974, si dhe nisur nga fakti se debitorit i është dorëzuar urdhri përmbartimor me datë 05.11.2020, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimin ka filluar të rrjedhë nga data 06.11.2020, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimin ka qenë data 12.11.2020.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes mori parasysh pretendimet e debitorit i cili në prapësim ka theksuar se organi përmbartues është dashur që urdhrin t'ia dorëzoj Avokaturës Shtetërore si institucion i cili sipas ligjit për Avokaturën Shtetërore përfaqëson autoritete publike të Republikës së Kosovës, mirëpo gjeti se dorëzimi i urdhrin përmbartimor debitorit është bërë konform dispozitave ligjore me të cilat rregullohet mënyra e komunikimit me persona juridik dhe organe shtetërore, përkatësisht dispozitave nga neni 104, paragrafi 1 dhe të të LPK-së, me të cilat përcaktohet se "*1 Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u bëhet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizua për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalitetin e punës, dhe 2, Dërgimi personit juridik mund t'i bëhet edhe nëpërmjet njësisë së tij po që se kontesti ka lindur nga raporti juridiko-civil i saj*".

Dhoma e Shkallës së Dytë, e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka hudhë poshtë prapësimin e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 826/20 të datës 23.10.2020 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala si i pasafatshme, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se debitori qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme e ka refuzuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 826/20 të datës 23.10.2020 me datën 05.11.2020, pa ndonjë arsytim atëher data e pranimit të urdhërit duhet të merret data 05.11.2020 përkatësisht data e refuzimit të pranimit të dërgesës dhe at sipas nenit 112 të LPK-së, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimin ka filluar të rrjedhë nga data 06.11.2020, dhe rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimin ka qenë data 12.11.2020.

Sipas nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se: "*Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrit përmbartues*", ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se: "*Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme*". Andaj duke marrë parasysh faktin se debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr. 826/20 të datës 23.10.2020, e ka refuzuar me datë 05.11.2020 (ditë e ejte) pa ndonjë arsytim atëher data e pranimit të urdhërit duhet të merret data 05.11.2020 përkatësisht data e refuzimit të pranimit të dërgesës dhe at sipas nenit 112 të LPK-së, kurse afati për paraqitjen e prapësimin ka filluar të rrjedhë nga data 06.11.2020 (ditë e premte) kalendari i muajit Nëntorë-2020, rezulton se dita e fundit për

paraqitjen e prapësimit ka qenë data 12.11.2020 (ditë e ejte). Nga kjo rezulton se debitori ka paraqitur ankesa me vonesë, pra jashtë afatit kohor

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 05.04.2022, e cila vërtetohet përmes postës rekomande me numër R 2301974, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara me ligje pra, prapësimi i debitorit është ushtruar jashtë afatit të përcaktuar konform nenit 70 të LPP-së.

Gjykata e shkallës se dytë analizoi edhe pretendimet e debitorit në ankesë lidhur me at se përmbaruesi privat për kundër masave kufezuese për mbrotje nga pandemia Covid-19 ka lëshuar urdhërin përmbarimor dhe çka është e habitshme që urdhëri përmbarimor është refuzuar nga udhëheqësi i QPD-së në Pejë në kohën kur kemi qenë të kufizuar, por i refuzoj si të pabazuar për shkak se në kohën e pandemis të gjitha institucionet publike kanë punuar me stafë të reduktuar dhe se nuk ka qenë penges për pranimin e shkresave, e për më tepër me rastin e refuzimi të urdhërit nuk është dhënë asnjë arsytim të vetëme, ndërsa në anën tjetër prapësim i debitorit është ushtruar tek me datën 04.04.2022 që i bie përafërsisht pas një viti e gjysëm, andaj kjo gjykatë vlerësoj se pretendimet e debitorit janë të pa bazuar dhe si e till ankesa refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet.

Kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore lidhur me at se organi përmbarues është dashur që urdhërin t'ia dorëzoj Avokaturës Shtetërore si institucion i cili sipas ligjit Avokatura Shtetërore përfaqëson autoritete publike të Republikës së Kosovës, mirpo të njejta pretendime janë vlerësuar edhe nga gjykata e shkallës së parë ku dhe ka dhënë sqarime lidhur me këtë pretendim, por i vlerësoj edhe kjo gjykata mirëpor të njejta i refuzoj si të pa bazuar për faktin se propozimi për lejimin e përmbarimit është paraqit kundër debitorit Ministria Për Punë të Mbredshme e jo avokatura shtetërore si përfaqësues i tij, andaj debitori është dasht që për të njejtën ta njoftoj përfaqësuesin e tij lidhur me çështjen në fjalë.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendim

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1504/23 me datë 28.05.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri